



M. 25 prot
20.17/07/23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



VENDIM

Nr. 20, datë 12.07.2023

PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR AKUAKULTURË (NË RASTIN E UJËRAVE
TË RRJEDHSHËM) NË RASTIN KUR PËRDORIMI ËSHTË PËR
>5 TON/VIT, >5 L/SEK”, TË SUBJEKTIT “REDI-2004” SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtime në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për akuakulturë (në rastin e ujërave të rrjedhshëm) në rastin kur përdorimi është për >5 ton/vit, >5 l/sek”, të subjektit “Redi-2004” sh.p.k, me vendndodhje: Fshati Borovë, Njësia Administrative Stërblevë, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Emri i burimit ujor: Lumi Zalli i Okshtunit.

Vendndodhja e burimit ujqor (KRGJSH):

Pika F1: X= 535376 Y = 4580020 Z= 867.1 m.m.n.d
Pika F2: X= 535342 Y = 4579983 Z= 869.7 m.m.n.d

Prurja mesatare vjetore: Q= 150 l/sek

Sasia e ujit që jepet për përdorim: Q= 150 l/sek

Lloji i aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: Për akuakulturë (rritje dhe kultivim i troftës dhe krapit).

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)

Pika SH1: X= 535370 Y= 4579996 Z= 865.4 m.m.n.d
Pika SH2: X= 535363 Y= 4579975 Z= 864.8 m.m.n.d
Pika SH3: X= 535353 Y= 4579960 Z= 864.4 m.m.n.d
Vëllimi i rrjedhës së kthyer: Q= 150 l/sek

Trupi ujqor pritës: Vaskë e depozitimit të mbetjeve (me pastrim periodik), më tej shkarkimi i ujit të pastër në lumë.

4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

